



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:149606

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05736806

C.nr.245/22

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nderim Musa, në çështjen juridike kontestimore të paditësit V.Z., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Xh.S., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Posta e Kosovës Sh.A. me seli në Prishtinë, me objekt kontesti, anulim vendimi dhe kthim në vendin e punës, jashtë seance, me datë **27.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë padia e paditësit V.Z., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, kundër të paditurës Posta e Kosovës Sh.A. me seli në Prishtinë, për anulim vendimi dhe kthim në vendin e punës, **SI E PALEJUESHME**.

A r s y e t i m

Paditësi V.Z., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi me datë 20.07.2022, në këtë gjykatë, kundër të paditurës Posta e Kosovës Sh.A. me seli në Prishtinë, për anulim vendimi dhe kthim në vendin e punës.

Gjykata me datë 23.04.2024, ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi, ku e paditura me datë 16.05.2024, ka bërë përgjigje në padinë e paditësit.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi, vlerësoi afatshmërinë e padisë, dhe erdhi në përfundim se padia e paditësit për anulimin e vendimit dhe kthimin në vendin e punës është paraqitur pas afatit të paraparë ligjor me dispozitat nga Ligji Nr. 03/L-212, i Punës.

Me dispozitat e nenit 78 paragrafi 1 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: *“I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te*

punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura”, ndërsa me paragrafin 2 përcaktohet se: “Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës”.

Me dispozitën e nenit 79 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: *“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”.*

Në kuptim të dispozitave të lartcekura, gjykata vlerësoi, se paditësi padinë për anulim vendimi dhe kthim në vendin e punës e ka paraqitur jashtë afatit ligjor, kjo pasi, paditësi kundër Vendimit mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës nr.01-1054/22, të datës 23.05.2022, ka paraqitur ankesë me datë 02.06.2022, që vërtetohet nga vula e protokollit nr.01-1160/2022, që mbanë datën e pranimit të ankesës nga ana e punëdhënësit, këtu e paditura, ndërsa paditësi padinë e ka paraqitur me datë 20.07.2022.

Paditësi me rastin e paraqitjes së ankesës me datë 02.06.2022, pranë të paditurës, është dashur të presë 15 ditë për të marrë përgjigje lidhur me ankesën e tij, në kuptim të nenit 78 par. 2 të Ligjit të Punës, dhe pastaj, në afat prej 30 ditësh të paraqesë padinë në gjykatë, në kuptim të nenit 79 të Ligjit të Punës, sepse dispozita e nenit 79 e Ligjit të Punës, rregullon edhe heshtjen e punëdhënësit në raport me ankesën e parashtruar nga të punësuarit, sepse ndër të tjerash me këtë dispozitë përcaktohet se: *“...ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”*, andaj, paditësi ka pas detyrim vetëm 15 ditë të presë për të marrë përgjigje, dhe pastaj t’i drejtohet gjykatës me padi.

Gjykata vlerëson se afati prej 30 ditësh për të paraqitur padi në gjykatë ka filluar të rrjedhë ditën e nesërme pas përfundimit të afatit prej 15 ditësh nga paraqitja e ankesës, dhe jo prej ditës kur paditësi e ka pranuar vendimin me të cilën është refuzuar ankesa e tij e paraqitur kundër Vendimit mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës nr.01-1054/22, të datës 23.05.2022.

Prandaj, paditësi ditën e fundit për të paraqitur padinë e ka pasur me datë 18.07.2022, (sepse dita e 17.07.2020, ka qenë ditë pushimi, e diel), pasi afati i fundit prej 15 ditësh për të vendosur për

ankesën e paditësit nga ana e punëdhënësit, këtu e paditura, ka qenë data 17.06.2022, dhe me kalimin e afatit prej 15 ditësh, ka filluar në rrjedhë afati prej 30 ditësh, për të paraqitur padinë në gjykatë.

Andaj, nga të lartcekurat e në kuptim të nenit 391 par. 1. pika f), të LPK-së, ku përcaktohet se: *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj”*, lidhur me nenin 393 dhe 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimit, duke e hedhur padinë si të palejueshme, pasi është paraqitur jashtë afatit ligjor.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.245/22, të datës 27.05.2024

Gjyqtari
Nderim Musa

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.